



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Adresa : Lagjia 7, Rruga “28 Nëntori”, Tel & Fax ++355(0) 82242009 www.qarkukorce.gov.al

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL,
LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË
EKZEKUTIVE**

Në zbatim të nenit 22 dhe 25, të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave të ndryshuar me VKM nr. 746, datë 19.12.2018, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Njësia Përgjegjëse) pranë Këshillit të Qarkut Korçë shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive për pozicionin:

2 (dy) Specialistë në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës Korçë -Kategoria IV- 3

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentave për **Lëvizje Paralele** është data **18.09.2023**

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentave për **Pranim në Shërbimin Civil** është data **25.09.2023**

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin:

- Rifreskon, administron dhe pasuron materialet arkivore (harta, libra ngastrash, etj)të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.
- Administron dhe evidenton të dhëna për tokën bujqësore, dhe kategoritë e tjera të saj dhe i pasqyrojnë ato në dokumentacionin kadastral.
- Referuar ligjit Nr. 8752 datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar, specialisti i drejtorisë së administrimit dhe mbrojtjes së tokës, kryen shërbime dhe jep informacion në bazë të dokumentacionit që disponon, sipas pikës 1 të këtij neni për sipërfaqen dhe vendndodhjen e ngastrave bazë të tokave
- Bashkëpunon me Drejtoritë e Urbanistikës në bashki lidhur me vendimet e marra prej tyre për sheshe e leje ndërtimi dhe pasqyrojnë ndryshimet e zërit kadastral në dokumentacionin

kadastral të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.

- e) Bashkëpunon me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, , njësitë e qeverisjes vendore, lidhur me ndryshimin e kategorisë së resurseve dhe pasqyrimin e tyre në dokumentacionin kadastral duke mbajtur evidenca në arkivin e DAMT-së.
- f) Bashkëpunon me ASHK-në lidhur me zërin kadastral të pasurive, përcaktimin e saktë të kufijve dhe problematikatë tjera të cilat hasen gjatë procedurës së regjistrimit.

1. LEVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Të zotërojë diplomë të nivelit “Master profesional” në agronomi dhe gjeodezi si dhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehësimi nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë) ose diplomë e integruar e nivelit të dytë.
- b) Të ketë njohuri të mira në programet bazë të kompjuterit.
- c) Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe menaxhuese.
- d) Prioritet kanë konkurentët me eksperiencë pune.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Këshillit të Qarkut Korçë brenda datës 18.09.2023 dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrim-standard>
- b- Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave të noterizuara (përfshirë edhe diplomën Master)
- c- Fotokopje të librezës së punës
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (Raport mjeko –ligjor)
- f – Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore (Deshmi Penaliteti)
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt
- h- Fotokopje të aktit të deklarimit të statusit
- i- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi
- j- Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 20.09.2023, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Këshillit të Qarkut Korçë ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të institucionit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin.
- Eksperiencën e tyre të mëparshme.
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuri mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- b) Njohuri mbi Kodin e Procedurave Administrative, i ndryshuar;
- c) Njohuri mbi Ligjin “Për vetëqeverisjen Vendore” (Ligji 139/2015) i ndryshuar;
- d) Njohuri mbi Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- e) Ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, i ndryshuar;
- f) Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “ Për parandalimin e konfliktit të interesit” i ndryshuar;
- g) Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 “ Rregullat e etikës në administratën publike”
- h) Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”;
- i) Ligjin Nr. 9693 datë 19.03.2007 “ Për fondin kullor”.
- j) Ligjin Nr. 9312 datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”.
- k) Ligjin Nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.
- l) Ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”
- m) j- VKM-në Nr.121, datë 17.2.2011, “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki”
- n) VKM Nr. 1174, datë 24.12.2020 “Për procedurat e regjistrimit të Amp-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese”.
- o) VKM Nr.655, datë 28.7.2010 “Për rregullat dhe procedurat e ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”;
- p) VKM Nr. 410, datë 27.6.2012 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”
- q) VKM Nr. 80 datë 28.01.2005 “Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtje së tokës bujqësore”.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv. (20 pikë- eksperiencia; 10 pikë- trajnimet; 10 pikë- në fushën përkatëse;)

60 pikë nga intervista e strukturuar me gojë:

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

Kandidati që merr më pak se 70 pikë nuk konsiderohet i suksesshëm.

Komisioni në përfundim të vlerësimit, njofton individualisht kandidatët që kanë konkuruar për rezultatin e tyre. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim në Komisionin e Brendshëm për Lëvizjen Paralele për rezultatin e vlerësimit, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankuesi merr përgjigje brenda 3 (tre) ditëve kalendarike, nga data e përfundimit të afatit të ankimit. Komisioni brenda 24 (njëzetë e katër) orëve pas përfundimit të procedurave të ankimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Këshillit të Qarkut Korçë. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike.

2. Pranimi në shërbimin civil

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen e “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të institucionit.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Të zotërojë diplomë të nivelit “Master profesional” në agronomi dhe gjeodezi si dhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehësimi nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë) ose diploma e integruar e nivelit të dytë.
- b) Të ketë njohuri mbi programet bazë të punës në kompjuter.
- c) Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe menaxhuese.
- d) Prioritet kanë konkurentët me eksperiencë pune.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Këshillit të Qarkut Korçë deri në datën 25.09.2023 dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave të noterizuara (përfshirë edhe diplomën Master);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (Raport mjeko –ligjor)
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore (Deshmi Penaliteti);
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 25.09.2023, në Institucionin e Këshillit të Qarkut Korçë.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 02.10.2023, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Institucionit të Këshillit të Qarkut Korçë, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHA E NJOHURIVE, AFTESITE DHE CILESITE MBI TE CILAT DO TE ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuri mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- b) Njohuri mbi Kodin e Procedurave Administrative, i ndryshuar;
- c) Njohuri mbi Ligjin “Për vetëqeverisjen Vendore” (Ligji 139/2015) i ndryshuar;
- d) Njohuri mbi Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- e) Ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, i ndryshuar;
- f) Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit” i ndryshuar;
- g) Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 “Rregullat e etikës në administratën publike”;
- h) Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”;
- i) Ligjin Nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”.
- j) Ligjin Nr. 9312 datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”.
- k) Ligjin Nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.
- l) Ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”
- m)j- VKM-në Nr.121, datë 17.2.2011, “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki”
- n) VKM Nr. 1174, datë 24.12.2020 “Për procedurat e regjistrimit të Amlp-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese”.
- o) VKM Nr.655, datë 28.7.2010 “Për rregullat dhe procedurat e ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”;
- p) VKM Nr. 410, datë 27.6.2012 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”
- q) VKM Nr. 80 datë 28.01.2005 “Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtje së tokës bujqësore”.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b - Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;

c - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Nëse kandidati grumbullon më shumë se gjysmën e pikëve (mbi 30 pikë) nga vlerësimi me shkrim, ai kualifikohet për të kaluar në procesin e vlerësimit të intervistës së strukturuar me gojë dhe jetëshkrimin.

Kandidati që merr më pak se 70 pikë nuk konsiderohet i suksesshëm.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).